

**LIGJ**  
**Nr. 9262, datë 29.7. 2004**

**PËR RATIFIKIMIN E “PROTOKOLLIT SHITESË TË KONVENTËS PËR KRIMIN KIBERNETIK, PËR PENALIZIMIN E AKTEVE ME NATYRË RACISTE DHE KSENOFOBE TË KRYERA NËPËRMJET SISTEMEVE KOMPJUTERIKE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet “Protokolli shtesë i Konventës për krimin kibernetik, për penalizimin e akteve me natyrë raciste dhe ksenofobe të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4291, datë2.8.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

**PROTOKOLLI SHITESË**

**I KONVENTËS MBI KRIMIN KIBERNETIK MBI PENALIZIMIN E AKTEVE ME NATYRË RACISTE DHE KSENOFOBIKE TË KRYERA NËPËRMJET SISTEMEVE KOMPJUTERIKE**

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtetet e tjera palë në Konventën mbi krimin kibernetik, të hapur për nënshkrim në Budapest më 23 nëntor 2001, nënshkruese të saj,

*duke pasur* parasysh se qëllimi i Këshillit të Europës është arritja e një uniteti më të madh ndërmjet anëtarëve të tij;

*duke kujtuar* se të gjitha qeniet njerëzore kanë lindur të lira dhe të barabarta në lidhje me dinjitetin dhe të drejtat;

*duke theksuar* nevojën për të siguruar një zbatim të plotë dhe të efektshëm të të gjitha të drejtave të njeriut pa diskriminim ose dallim, siç janë parashikuar në instrumentet europiane dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare;

*të bindur* se aktet e natyrës raciste dhe ksenofobike përbëjnë shkelje të të drejtave të njeriut dhe një kërcënim për shtetin ligjor dhe stabilitetin demokratik;

*duke pasur* parasysh se të drejtat kombëtare dhe ndërkombëtare duhet të japin përgjigjet e duhura ligjore në lidhje me propagandën e natyrës raciste dhe ksenofobike me anë të sistemeve kompjuterike;

*të ndërgjegjshëm* për faktin se propaganda për akte të tilla është shpesh objekti i penalizimit në legjislacionin kombëtar;

*duke iu referuar* Konventës mbi krimin kibernetik, e cila parashikon mjete moderne dhe elastike për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe të bindur për nevojën e harmonizimit të dispozitave të ligjit material në lidhje me luftën kundër propagandës raciste dhe ksenofobike;

*të ndërgjegjshëm* se sistemet kompjuterike ofrojnë një mjet të paparë për lehtësimin e lirisë së shprehjes dhe komunikimit në të tërë globin;

*duke pranuar* se liria e shprehjes përbën një nga themelet bazë të një shoqërie demokratike, një nga kushtet thelbësore për përparimin e saj dhe për zhvillimin e çdo qenieje njerëzore;

*por të shqetësuar* për rrezikun e keqpërdorimit dhe abuzimit të këtyre sistemeve kompjuterike për shpërndarjen e propagandës raciste dhe ksenofobike;

*duke njohur* nevojën për të siguruar një ekuilibër ndërmjet lirisë së fjalës dhe një lufte të efektshme kundër

akteve të natyrës raciste dhe ksenofobike;

*duke pranuar* se ky protokoll nuk synon të ndikojë mbi parimet e pranura në lidhje me lirinë e fjalës në sistemet ligjore kombëtare;

*duke marrë* parasysh instrumentet përkatëse ndërkombëtare në këtë fushë, sidomos Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollin 12 të saj mbi ndalimin e diskriminimit, konventat ekzistuese të Këshillit të Europës mbi bashkëpunimin në fushën penale, sidomos Konventën mbi krimin kibernetik, Konventën mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial të 21 dhjetorit 1965, Veprimin e Përbashkët të 15 korrikut 1996 të Bashkimit Europian të adoptuar nga Këshilli mbi bazën e nenit k.3 të Traktatit të Bashkimit Europian, në lidhje me masat për të luftuar racizmin dhe ksenofobinë;

*duke mirëpritur* zhvillimet e fundit që çojnë më tej mirëkuptimin ndërkombëtar dhe bashkëpunimin në luftën kundër krimit kibernetik, si edhe racizmit dhe ksenofobisë;

*duke pasur* parasysh planin e veprimit të adoptuar nga kryetarët e shteteve dhe qeveritë e Këshillit të Europës në rastin e Samitit të tyre të dytë (Strasburg, 10-11 tetor 1997) për të kërkuar përgjigje të përbashkëta ndaj zhvillimeve të teknologjive të reja të bazuara mbi standardet dhe vlerat e Këshillit të Europës, kanë rënë dakord si më poshtë:

## KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij protokoll është të plotësojë, ndërmjet Palëve në protokoll, dispozitat e Konventës mbi krimin kibernetik, të hapur për nënshkrim në Budapest më 23 nëntor 2001 (tani do të quhet “Konventa”), në lidhje me penalizimin e akteve të natyrës raciste dhe ksenofobike të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike.

### Neni 2 Përkufizimi

1. Për qëllimet e këtij protokoll:
  - “material racist dhe ksenofobik” është çdo material i shkruar, çdo imazh ose përfaqësim tjetër i mendimeve ose teorive, që favorizon, përhap ose nxit urrejtje, diskriminim ose dhunë kundër çdo individi ose grupi individësh, bazuar mbi racën, ngjyrën, prejardhjen, origjinën kombëtare ose etnike, si edhe fenë, nëse përdoret si pretekst për çdonjërin nga këta faktorë.
2. Termat dhe shprehjet e përdorura në këtë protokoll interpretohen në të njëjtën mënyrë siç interpretohen edhe termat dhe shprehjet sipas Konventës.

## KAPITULLI II MASAT QË DUHET TË MERREN NË NIVEL KOMBËTAR

### Neni 3 Shpërndarja e materialeve raciste dhe ksenofobike në një sistem kompjuterik

1. Çdo shtet palë ndërmerr masa legjislative, si dhe masa të tjera, të nevojshme për të përcaktuar si vepër penale, sipas ligjit të brendshëm, sjelljen e mëposhtme, kur kryhet me qëllim dhe pa të drejtë:
  - shpërndarjen ose ndryshe bërjen publike nëpërmjet një sistemi kompjuterik të materialeve raciste dhe ksenofobike.
2. Një palë mund të rezervojë të drejtën për të mos ngarkuar me përgjegjësi penale një sjellje sipas parashikimit të paragrafit 1 të këtij neni, kur materiali, sipas parashikimit të nenit 2 paragrafi 1, favorizon, përhap ose nxit diskriminimin që nuk lidhet me urrejtje ose dhunë, me kusht që të jenë të mundshme mjete të tjera të efektshme.
3. Në ndryshim nga paragrafi 2, një palë mund të rezervojë të drejtën për të mos zbatuar paragrafin 1 në ato raste diskriminimi për të cilat në sajë të principeve të përcaktuara në sistemin ligjor kombëtar, nuk mund të

parashikojë mjete të efektshme sipas përcaktimit të paragrafit 2.

#### Neni 4

### **Kërcënimi me motive racizmi dhe ksenofobie**

Çdo shtet palë ndërmerr masa legjislative, si dhe masa të tjera, të nevojshme për të përcaktuar si veprë penale, sipas ligjit të brendshëm, sjelljen e mëposhtme, kur kryhet me qëllim dhe pa të drejtë:

- kërcënimin, nëpërmjet një sistemi kompjuterik, me kryerjen e një veprë të rëndë penale sipas parashikimit në ligjin e brendshëm, (i) të personave për arsyen se i përkasin një grupi, të dalluar nga raca, ngjyra, prejardhja, origjina kombëtare ose etnike, si dhe feja, kur përdoret si pretekst për njërin nga këta faktorë, ose (ii) të një grupi personash që dallohet nga njëra prej këtyre karakteristikave.

#### Neni 5

### **Fyerja me motive racizmi dhe ksenofobie**

1. Çdo shtet palë ndërmerr masa legjislative, si dhe masa të tjera, të nevojshme për të përcaktuar si veprë penale, sipas ligjit të brendshëm, sjelljen e mëposhtme, kur kryhet me qëllim dhe pa të drejtë:

- fyerjen, nëpërmjet një sistemi kompjuterik, publikisht, (i) të personave për arsyen se i përkasin një grupi, të dalluar nga raca, ngjyra, prejardhja, origjina kombëtare ose etnike, si dhe feja, kur përdoret si pretekst për njërin nga këta faktorë, ose (ii) të një grupi personash që dallohet nga njëra prej këtyre karakteristikave.

2. Çdo shtet palë mund:

i) të kërkojë që vepra penale e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni të ketë efektin që personi ose grupi i personave të përmendur në paragrafin 1 t'i jenë ekspozuar urrejtjes, përçmimit ose vënies në lojë, ose

ii) të rezervojë të drejtën për të mos zbatuar, plotësisht ose pjesërisht, paragrafin 1.

#### Neni 6

### **Mohimi, minimizimi i konsiderueshëm, aprovimi ose justifikimi i genocidit ose krimeve kundër njerëzimit**

1. Çdo shtet palë ndërmerr masa legjislative, si dhe masa të tjera, të nevojshme për të përcaktuar si veprë penale sipas ligjit të brendshëm sjelljen e mëposhtme, kur kryhet me qëllim dhe pa të drejtë:

- shpërndarjen ose ofrimin në publik nëpërmjet një sistemi kompjuterik të materialit që mohon, minimizon në mënyrë të konsiderueshme, aprovon ose justifikon akte që përbëjnë gjenocid ose krime kundër njerëzimit, sipas të drejtave ndërkombëtare dhe të njohura si të tilla me vendime të formës të prerë dhe të detyrueshme të Gjykatës Ndërkombëtare Ushtarake, të krijuara nga Marrëveshja e Londrës e 8 prillit 1945 ose të ndonjë gjykate tjetër ndërkombëtare, të krijuar me instrumentet përkatëse ndërkombëtare, juridiksioni i të cilave është njohur nga ky shtet palë.

2. Çdo shtet palë mund:

i) të kërkojë që mohimi ose minimizimi i konsiderueshëm i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni të jetë kryer për të nxitur urrejtjen, diskriminimin ose dhunën kundër një individi ose grupi individësh, bazuar mbi racën, ngjyrën prejardhjen, origjinën kombëtare ose etnike si dhe fenë, nëse përdoret si pretekst për një nga këta faktorë ose

ii) të rezervojë të drejtën për të mos zbatuar, plotësisht ose pjesërisht, paragrafin 1.

#### Neni 7

### **Ndihma dhe shtytja**

1. Çdo shtet palë ndërmerr masa legjislative, si dhe masa të tjera, të nevojshme për të përcaktuar si veprë penale sipas ligjit të brendshëm sjelljen e mëposhtme, kur kryhet me qëllim dhe pa të drejtë:

- dhënien e ndihmesës ose shtytjen në kryerjen e njëres prej veprave penale të parashikuara në këtë protokoll, me synimin që një veprë e tillë të kryhet.

## KAPITULLI III

### RAPORTI NDËRMJET KONVENTËS DHE KËTIJ PROTOKOLLI

## Neni 8

### Raporti ndërmjet Konventës dhe këtij protokoll

1. Nenet 1, 12, 13, 22, 41, 44, 45 dhe 46 të Konventës zbatohet *mutatis mutandis* në këtë protokoll.
2. Palët e zgjerojnë sferën e zbatimit të masave të përcaktuara në nenet 14 deri në 21 dhe nenet 23 deri në 35 të Konventës te nenet 2 deri në 7 të këtij protokoll.

## KAPITULLI IV DISPOZITA TË FUNDIT

## Neni 9

### Shprehja e pëlqimit për marrjen përsipër të detyrimit

1. Ky protokoll është i hapur për t'u nënshkruar nga shtetet që kanë nënshkruar Konventën, të cilët mund t'a shprehin marrjen përsipër të detyrimit nëpërmjet:
  - a) nënshkrimit pa rezervë në lidhje me ratifikimin, pranimin ose aprovimin; ose
  - b) nënshkrimit që i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose aprovimit, që pasohet nga ratifikimi, pranimi ose aprovimi.
2. Një shtet mund të mos e nënshkruajë këtë protokoll pa rezerva në lidhje me ratifikimin, pranimin ose aprovimin apo të depozitojë një instrument ratifikimi, pranimi ose aprovimi, nëse nuk ka depozituar më parë ose depoziton njëkohësisht një instrument ratifikimi, pranimi ose aprovimi të Konventës.
3. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose aprovimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

## Neni 10

### Hyrja në fuqi

1. Ky protokoll hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati tremujor pas datës në të cilën pesë shtete kanë shprehur pëlqimin e tyre për t'u nënshtuar protokollit, në përputhje me dispozitat e nenit 9.
2. Në lidhje me ato shtete që e shprehin pëlqimin e tyre më vonë për t'u nënshtuar protokollit, ky hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati tremujor pas datës së nënshkrimit të tij pa rezerva në lidhje me ratifikimin, pranimin, aprovimin ose depozitim të tyre të ratifikimit, pranimit ose aprovimit.

## Neni 11

### Aderimi

1. Pas hyrjes në fuqi të këtij protokoll, çdo shtet që ka aderuar në Konventë mund të aderojë edhe në protokoll.
2. Aderimi kryhet nëpërmjet depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës të një instrumenti aderimi i cili hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati tremujor pas datës së depozitimit.

## Neni 12

### Rezervat dhe deklaratimet

1. Rezervat dhe deklaratimet që bëhen nga një shtet për një dispozitë të Konventës janë të zbatueshme edhe për këtë protokoll, përveç rasteve kur ai shtet deklaron ndryshe në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, aprovimit apo aderimit.
2. Nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, çdo shtet, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit, mund të deklarojë se i njeh vetes rezervën (at) e parashikuar në nenet 3, 5 dhe 6 të këtij protokoll. Në të njëjtën kohë, një shtet palë mund t'i njohë vetes, në lidhje me dispozitat e këtij protokoll, rezervën(at) e parashikuara në nenin 22 paragrafi 2 dhe nenin 41 paragrafi 1 të Konventës, pavarësisht nga zbatimi që i bën Konventës ky shtet palë. Nuk mund të bëhen rezerva të tjera.
3. Nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, çdo shtet, në

momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit, mund të deklarojë se i njeh vetes mundësinë e kërkimit të elementeve shtesë të parashikuara në nenin 5 paragrafi 2.a dhe nenin 6 paragrafi 2.a të këtij protokoll.

#### Neni 13

### **Statusi dhe tërheqja e rezervave**

1. Çdo shtet palë që ka bërë një rezervë në lidhje me nenin 12 më sipër mund ta tërheqë këtë rezervë, plotësisht ose pjesërisht, menjëherë sapo rrethanat t'ia lejojnë këtë. Një tërheqje e tillë bëhet e efektshme në datën e marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës. Nëse njoftimi parashikon se tërheqja e një rezerve bëhet e efektshme në një datë të përcaktuar atje, dhe kjo datë është më e vonshme se data në të cilën njoftimi merret nga Sekretari i Përgjithshëm, tërheqja bëhet e efektshme në datën e përcaktuar aty.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës mund të interesohet periodikisht te çdo shtet palë që ka bërë një ose më shumë rezerva mbështetur në nenin 12 në lidhje me mundësitë e tërheqjes së kësaj (këtyre) rezerve.

#### Neni 14

### **Zbatimi territorial**

1. Çdo shtet palë në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit mund të përcaktojë territorin ose pjesët e territorit në të cilin zbatohet ky protokoll.

2. Çdo shtet, në një datë të mëvonshme, nëpërmjet një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të zgjerojë zbatimin e këtij protokoll në çdo pjesë tjetër territori të përcaktuar në deklaratë. Në lidhje me këtë pjesë territori, protokollin hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati tremujor pas datës së marrjes së kësaj deklarate nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafëve të mësipërm, në lidhje me një pjesë territori të përcaktuar aty, mund të tërhiqet nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati tremujor pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

#### Neni 15

### **Denoncimi**

1. Çdo shtet palë, në çdo kohë, mund ta denoncojë këtë protokoll nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Një denoncim i tillë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati tremujor pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

#### Neni 16

### **Njoftimet**

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton shtetet anëtare të Këshillit të Europës, shtetet joanëtare që kanë marrë pjesë në përpilimin e këtij protokoll, si dhe çdo shtet që ka aderuar ose është ftuar që të aderojë në këtë protokoll në lidhje me:

- a) çdo nënshkrim;
- b) depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi, aprovimi ose aderimi;
- c) çdo datë të hyrjes në fuqi të këtij protokoll në pajtim me nenet 9, 10 dhe 11;
- d) çdo akt, njoftim ose komunikim tjetër që ka të bëjë me këtë protokoll.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë protokoll.

Bërë në Strasburg, më 7 nëntor 2002, në anglisht dhe frëngjisht, në dy tekste njëloj autentike, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës u dërgon kopje të vërtetuara të gjitha shteteve anëtare të Këshillit të Europës, shteteve joanëtare që kanë marrë pjesë në përpilimin e këtij protokoll, si dhe çdo shteti të ftuar për të aderuar në të.